



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2024:019668  
Datë: 21.05.2024  
Numri i dokumentit: 05720160

**AA.nr.461/2024**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS** - Departamenti për Çështje Administrative, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Delushe Halimi, kryetare e kolegjit, Ramiz Kuqi dhe Hajriz Hoti, anëtarë, në konfliktin administrativ të paditësit/propozuesit M. P. nga P., të cilën me autorizim e përfaqëson V. H. avokat-L. T. L. me adresë në rr.”...” nr.... kati i ..., P., kundër të paditurit Qeveria e Republikës së Kosovës-Kryeministri i Republikës së Kosovës, me bazë juridike, anulim vendimi me propozim për shtyrjen e ekzekutimit të të njëjtit, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të ushtruar kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje administrative, A.nr.139/24, të datës 15.02.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 21.05.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**Aprovohet** si e bazuar ankesa e paditësit/propozuesit M.P., e datës 05.03.2024, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.139/24, i datës 15.02.2024, anulohet dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

**A r s y e t i m**

Me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, është huldë poshtë si e palejuar padia e paditësit/propozuesit M.P. nga P., të cilën me autorizim e përfaqëson V. H. avokat-L. T. L. me adresë në rr.”...” nr.... kati i ..., P., e ushtruar kundër të paditurit Kryeministri i Republikës së Kosovës, nën shenjë A.nr.139/24 e datës 18.01.2024 dhe plotësimi i saj i datës 14.02.2024.

Kundër këtij aktvendimi në afatin e lejuar ligjor, ankesë ka ushtruar i autorizuari i paditësit, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet në tërësi si e bazuar ankesa e paditësit, ashtu që prishet aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për çështje administrative, A.nr.139/24, i datës 15.02.2024 dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar në drejtim të pretendimeve me ankesë, si në vështrim të nenit 49 të LKA, dhe neni 194 i LPK-së, (ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA), dhe gjen se:

#### Ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi ka ushtruar padi kundër të paditurës, në gjykatën e shkallës së parë me propozim për shtyrjen e ekzekutimit të të njëjtit duke kërkuar anulimin e Rregullores ZKM me nr.... për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e vendeve të Punës të Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë.

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e ankimuar të cekur si më lartë, vendos si në dispozitiv të saj, duke e hudhë si të pa lejuar padinë dhe propozimin e paditësit, me arsyetim se; duke u bazuar në nenin 9 të Ligjit për Konfliktet Administrative, paditësi-propozuesi as me padi dhe as me plotësimin e saj nuk ka precizuar saktë palën e paditur e as se cilin akt administrativ propozohet të anulohet apo në mungesë të tij çfarë akti administrativ të nxirret, sipas së cilit do të mund të ngritej padi administrative, prandaj mbi këto arsye, Gjykata vlerësoi se në raport me këtë vendim, nuk mund të hapet konflikti administrativ me padi, në pajtim me nenin 34, paragrafin 1, nën-paragrafin 1.5, lidhur me nenin 9 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, pikëpamjet juridike të gjykatës së shkallës së parë, nuk mund ti përkrahë si të rregullta dhe të ligjshme, për arsye se aktvendimi i ankimuar është i përfshirë me të metat thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 të LPK pika nën n) e cila përcakton se: *“në qoftë se aktgjykimi ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohen, e sidomos në qoftë se dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetvete ose me arsyet e aktgjykimit, apo nëse aktgjykimi nuk ka fare arsye apo në të nuk janë treguar fare arsytet për faktet vendimtare, ose ato arsytet janë të paqarta, ose kontradiktore, ose nëse për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit thuhet për përmbajtje të dokumentit ose të procesverbalit për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vet atyre dokumenteve ose të procesverbalit”*.

Gjykata e shkallës së parë, nuk e ka vlerësuar drejtë kërkesë padinë e paditësit për arsye se kërkesëpadija e paditësit është kundërshtimi i vendimit me nr... i datës ..., me të cilin ka kërkuar që të anulohet dhe të vlerësohet Rregullorja (ZKM)-nr. ... për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve, dhe se me këtë rast kushtet e padisë janë plotësuar dhe i njëjti ka të drejtë të fillojë procedurën e konfliktit administrativ sepse në shkresat e lëndës e kemi vendimin kontestues si dhe padia e paditësit është e qartë e plotë dhe e njëjta është konform dispozitave të LKA-së. Në bazë të kësaj gjendje gjykata e shkallës së parë duhet të vazhdojë procedurën në këtë çështje dhe të vlerësojë ligjshmërinë e vendimit kontestues të kontestuar me padi.

Në rigjykim gjykata e shkallës së parë duhet ti eliminojë shkeljet e theksuara më lartë të vendos lidhur me propozimin për shtyrje të ekzekutimit të vendimit, të kujdeset që dispozitivi të jetë i qartë dhe në përputhje të plotë me arsyetimin, të vendos në tërësi lidhur me kërkesën e propozuesit dhe të njëjtën ta arsyetojë me prova konkrete, ashtu siç kërkohet me dispozitat ligjore në fuqi.

Nga gjendja e tillë e çështjes e vërtetuar si më lartë kolegji vlerëson se në këtë çështje duhet pranuar si të lejuar padinë e paditësit dhe gjykata e shkallës së parë të vlerësoj propozimin për masë të përkohshme se a i plotëson kushtet e parapara me nenin 22 të LKA-së dhe të vendos lidhur me të. Andaj kolegji i Gjykatës së Apelit vendosi që Aktvendimin e Gjykatës Themelore Prishtinë, ta anuloi, ndërsa lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë, në rivendosje.

Nga të lartë cekurat e në vështrim të nenit 49 të LKA-së, dhe neni 209, par. d) të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA E APELT E KOSOVËS - PRISHTINË**  
**AA.nr.461/2024, me datë 21.05.2024**

**Kryetare e kolegjit,**  
**Delushe Halimi**